



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 549, datë 29.9.2021

**PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË ARMATIMIT, TË LËNDËVE
NEUROPARALIZUESE, TË MJETEVE DHE TË PAJISJEVE TË TJERA
KUFIZUESE, PËR PËRDORIMIN E FORCËS NGA GARDA
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 62, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese (lëndë kimike për kontrollin e turmave), të mjeteve dhe të pajisjeve të tjera kufizuese, për përdorimin e forcës nga Garda e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Deri në rinovimin e plotë të armatimit, strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë përdorin armatimin e pajisjet aktuale.

3. Vendimi nr. 830, datë 1.12.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për pajisjen e punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë me armatim dhe mjete teknike të posaçme”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA NR. 1

**LLOJET E ARMATIMIT, LËNDËT NEUROPARALIZUESE (LËNDË KIMIKE PËR
KONTROLLIN E TURMAVE), MJETET DHE PAJISJET E TJERA KUFIZUESE, PËR
PËRDORIMIN E FORCËS NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Punonjësit dhe strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë pajisen me armatim, lëndë neuroparalizuese (lëndë kimike për kontrollin e turmave), mjete dhe pajisje të tjera kufizuese për përdorimin e forcës gjatë kryerjes së detyrave të ngarkuara, sipas funksionit organik të çdo punonjësi të Gardës së Republikës së Shqipërisë, sipas kësaj lidhjeje.

Llojet e armatimit, të municioneve dhe të pajisjeve janë, si më poshtë vijon:

1. Armatim

1.1 Armë zjarri për përdorim individual:

a) armë të shkurtra zjarri (pistoletë) kalibër 9 x 19 mm.

1.2 Armë zjarri për përdorim kolektiv:

a) armë të gjata zjarri automatike kalibër 5.56 x 45 mm deri 9 x 19 mm.

1.3 Armë speciale:

- a) armë ceremoniale;
- b) armë të drejtuara me energji (ADE);
- c) armë me elektroshok;
- ç) armë e ftohtë;
- d) armë për përdorim/hedhje të municioneve dhe mjeteve të ndryshme (*shotgun*/lëshues);
- dh) armë pneumatike;
- e) armë e gjatë zjarri me përpikëri të lartë (snajper), gjysmautomatike, kalibër 5.56 x 45 mm deri 12.7 x 99 mm;
- ë) armë për sinjalizim;
- f) armë për sinjalizim të lehtë akustik;
- g) armë të tjera për përdorim, të cilat do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj në Republikën e Shqipërisë;
- gj) armë zjarri me zhurmëzbutës të montuar;
- h) armë zjarri sportive;
- i) mjete optike të armëve të zjarrit për shikim dhe shënjim;
- j) pjesë kryesore të armëve të zjarrit;
- k) pajisje e posaçme për armët e zjarrit.

2. Municion:

a) granata akustike, tymuese dhe verbuese për përdorim policor, të cilat nuk sjellin dëme të pakthyeshme të shëndetit dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese;

b) municione për armët e shkurtra e të gjata të zjarrit, sipas kalibrave përkatës, me të gjitha llojet e cilësisë së veprimit;

c) municione që hidhen me *shotgun* me saçme: gome, metalike, sintetike;

ç) municione me lëndë kimike (irrituese/ngacmuese) në formë pluhuri ose lëngu për përdorim policor, që hidhen me *shotgun*/lëshues, me granatë dore, pajisje hedhëse, *spray* (individual/kolektiv) ose tubat, për mbrojtjen, menaxhimin e kontrollin e turmave, të cilat nuk sjellin dëme të pakthyeshme të shëndetit dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, me kufi ngacmues 0.05–0.1 mg/m³, kufiri toksik 1–5 mg/m³, indeksi i avullimit 40.000–75000 mg/min/m³;

3. Pajisje kufizuese për përdorimin e forcës

3.1 Pajisje kufizuese për përdorimin e forcës (për përdorim individual):

- a) çantë me pllaka antiplumb e hapshme për mbulim VIP-i¹;
- b) jelek antiplumb;
- c) kaskë balistike antiplumb;
- ç) kaskë plastike;
- d) këmbishë jelek balistik;
- dh) kostum për mbrojtje nga mjetet e forta;
- e) mburojë balistike individuale, mburojë plastike për mjetet e forta;
- ë) mjete mbrojtëse gjatë qitjes (syze balistike, kufje mbrojtëse për qitje);
- f) mjete mbrojtëse nga lëndët kimike e bakteriologjike;
- g) pajisje dhe mjete komunikimi;
- gj) pajisje dhe mjete ndriçuese;
- h) pajisje dhe mjete optike;
- i) pajisje dhe mjete orientimi (GPS, busulla);
- j) pranga metalike dhe plastike;

¹ Personalitete të larta shtetërore.

k) shkop gome/metalik;

l) veshje antiexploziv.

3.2. Pajisje kufizuese për përdorimin e forcës (për përdorim kolektiv):

a) çantë valixhe antiexploziv, pasqyrë për kontrollin e mjeteve, pasqyrë teleskopike me kamera me rreze infra;

b) detektor kërkimi (metal, eksploziv, lëndë radioaktive/kimike), porta detektorë, skaner për kontrollin e sendeve, aparat eksploziv kërkues;

c) komplet universal xhenier (pincë, thikë, kaçavidë);

ç) pajisje dhe aparate për përcaktimin e pozicionit gjeografik dhe të distancave;

d) pajisje kontrolluese e testuese të qitjes;

dh) pajisje të lehta degazimi, dezinfektimi, si dhe lëndë degazuese e dezinfektuese;

e) pajisje dhe mjete kufizuese (barriera metalike, bllokues rrugësh, zinxhir kolektiv);

ë) pajisje dhe mjete optike (pajisje për shikim mbrapa pengesave; kamera termale, sondë infra të kuqe; dylbi dite dhe nate);

f) pajisje dhe mjete për operacione në lartësi (shkallë portative operacionale; pajisje alpinistike kolektive);

g) pajisje të tjera për përdorim policor, të cilat do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj në Republikën e Shqipërisë;

gj) pajisje vëzhgimi dhe zbulimi (dite dhe nate);

h) pajisje për zbulim kimik, biologjik, radioaktiv dhe ndotësit e mjedisit;

i) qen eksplozivkërkues;

j) robotë antiexplozivë dhe të ndryshëm;

k) sisteme dron/antidron dhe pajisje për bllokimin e valëve telefonike;

l) simulatorë trajnimi dhe aftësimi për çdo armë zjarri.

4. Sisteme sigurie, vëzhgimi dhe komunikimi:

a) pajisje dhe mjete komunikimi;

b) pajisje për sisteme e rrjete kompjuterike;

c) sisteme GPS (sisteme të përcaktimit të vendndodhjes);

ç) sisteme të vëzhgimit me kamera, sisteme të akses-kontrollit të personelit, sisteme të kontrollit të automjeteve, sisteme të kontrollit të perimetrit të objekteve, sisteme të sinjalizimit të rrezikut ndaj zjarrit e ujit.